



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni hetimor i Kuvendit “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”.

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.05.2021, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Alket Hyseni – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të datës 21 maj.
2. Seancë dëgjimore me Presidentin e Republikës.
3. Administrimi i provave.
4. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Alket Hyseni, Myslim Murrizi, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Elena Xhina, Spartak Braho, Nikolin Staka, Arlind Çaçani dhe Edmond Stojku.

Mungojnë:

Halil Jakimi,

HAPET MBLEDHJA

Alket Hyseni – Përshëndetje!

Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen “Për verifikimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”. Janë të pranishëm deputetët, numri i duhur për ta konsideruar mbledhjen të vlefshme. Nga opozita janë të katërt anëtarët. Nga maxhoranca janë katër anëtarë dhe në pritje për t’u bashkuar, zoti Braho. Atëherë, mbledhja konsiderohet e vlefshme.

Jeni dakord me rendin e ditës, të cilin e keni gjithsecili përpara? Pra, është miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit të datës 21 maj.

Seancë dëgjimore me Presidentin e Republikës.

Administrimi i provave.

Çështje të tjera.

Kush është dakord me rendin e ditës, ju lutem, të shprehet me ngritje dore?

Dakord të gjithë.

Miratohet.

Atëherë, fillojmë me shqyrtimin e pikave një nga një. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit të datës 21 maj.

Ka dikush vërejtje, komente për procesverbalin? Nuk ka. Të gjithë dakord.

Miratohet.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës. Seancë dëgjimore me Presidentin e Republikës.

Sikurse, bashkë si komision, kemi vendosur, por për t’ia bërë me dije edhe opinionit publik, Rregullorja e Kuvendit në nenin 112, pika 3 e saj përcakton detyrimin e komisionit hetimor për të thirrur e për të dëgjuar mendimin e Presidentit të Republikës. Komisioni hetimor i ka dërguar Presidentit të Republikës katër shkresa lidhur me të drejtën e tij për t’u shprehur në komision, por dhe detyrimin për ta thirrur në komision. Shkresën me nr.1081/10, datë 10.05.2021, nëpërmjet të cilës njoftohet Presidenti në lidhje me ngritjen e komisionit hetimor, objektin e hetimit, si dhe të drejtën e tij për t’u shprehur në këtë komision, shkresën nr. 1081/23 protokoli, datë 14.05.2021, ku thirret Presidenti i Republikës për t’u dëgjuar në seancën dëgjimore të datës 18.05.2021 ora 10:00, shkresën nr. 1081/32 protokoli, datë 18.05.2021, nëpërmjet të cilës

komisioni hetimor rithërret Presidentin e Republikës për ta dëgjuar në seancë dëgjimore në ditën dhe orën që Presidenti do ta konsiderojë të përshtatshme, duke i lënë atij një afat, nga data 19.05.2021, deri në datën 24.05.2021 dhe shkresën nr. 1081/36, datë 21.05.2021, nëpërmjet së cilës komisioni hetimor thërret Presidentin e Republikës në seancë dëgjimore të programuar për ditën e sotme, datë 24.05.2021.

Kabineti i Presidentit me shkresën e tij nr.1651/3 protokoli, datë 21.05.2021 i është drejtuar sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, duke cituar se procesi hetimor është i palegjitimuar, fiktiv dhe jashtë çdo lloj afati dhe po sot, në datë 24.05.2021, me shkresë të kabinetit të Presidentit me nr. 1714 të protokollit, drejtuar sekretarit të Përgjithshëm, citohet se Presidenti e ka shprehur qartë vullnetin e tij dhe qëndrimin e tij me shkresa të dërguara më parë. Ka dhe qëndrim të mëparshëm të Presidentit, të cilin e ka bërë me dije edhe komisioni.

Në këto kushte, edhe sikurse njoftohemi nga shërbimet e Kuvendit, nuk është paraqitur për t'u dëgjuar, Presidenti i Republikës.

Keni ndonjë mendim për këtë çështje?

Po, urdhëro, zoti Murrizi.

Myslim Murrizi - Faleminderit, zoti kryetar!

Po shikoj përgjigjen e ish-ministrit të bujqësisë, zotit Panariti dhe dua t'i bëj një pyetje zonjës Hysi apo zonjës Ferhati. A ka të drejtë...? Se ju thatë detyrimin. Çfarë detyrimesh ka komisioni hetimor? Ky është precedent që ndodhi me Presidentin e Republikës. Nëse në një komision hetimor të ngritur nga Kuvendi, më parë apo më pas (besoj se do të ketë komisione hetimore edhe në legjislaturën 2021-2025), një person publik, cilido qoftë ai, nuk vjen, si veprohet, sepse mund ta kopjojnë të gjithë praktikën e zotit President dhe thonë nuk duam të vijmë në komision hetimor. Atëherë, pse ngrihen komisionet hetimore? Unë isha zëvendësues për pak kohë te komisioni hetimor për zotin Tahiri. Për dijeninë time: a ka masa detyruese për të sjellë në komision? Nuk e kam me ju të dyja, le të përgjigjet kush të dojë.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Nëse do ta kishte dëgjuar këtë pyetje zoti Braho, ndoshta do të kishte kërkuar ai të përgjigjej.

Mirë se erdhët, zoti Braho!

Klotilda Bushka (Ferhati) – Zoti Murrizi, pyetja juaj është e drejtë. Bëhet fjalë për një proces parlamentar që ka të bëjë me punën e një komisioni hetimor, që është një mekanizëm i

parashikuar nga Kushtetuta dhe nga Rregullorja e Kuvendit, për të hetuar çështje me rëndësi të veçanta dhe shkarkimin e Presidentit, kur kjo kërkohet sipas parashikimeve në ligj. Komisioni hetimor vepron në bazë të ligjit për komisionet hetimore.

Sipas Rregullores së Kuvendit, por edhe ligjit, është detyrim i komisionit hetimor, në rastin konkret, ta thërrasë Presidentin për t'u dëgjuar. Sigurisht, ky komision hetimor vepron për atë që është e mundur dhe në bazë të rregullave të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilave, nëse pas disa thirrjeve personi i thirrur për t'u dëgjuar nuk paraqitet, mund edhe të kërkohet ardhja me forcë e personit në këtë komision, duke përdorur ato parashikime që jep Kodi i Procedurës Penale.

Thënë këtë, e cila është çfarë parashikon kuadri ligjor, më duhet t'ju vë në dijeni, pasi e lexova shkresën e Presidentit, ashtu siç kam lexuar edhe shkresën e parë, edhe shkresën e dytë, që më rezulton se komisioni hetimor ka garantuar në mënyrë objektive dhe të drejtë thirrjen e Presidentit të Republikës për t'u dëgjuar në këtë proces. Nëse lexojmë përgjigjet, keni jo vetëm një (kur ta lexoj zoti Braho, se besoj nuk e ka marrë akoma përgjigjen e fundit), gjuhë, e cila nuk i shkon për shtat as Presidentit ndaj Kuvendit, por nuk e meriton as Kuvendi, si përfaqësues i sovranit, përdorimin e këtyre etiketave që janë në shkresë.

Nga ana tjetër, në bazë të shkresës së Presidentit të Republikës, në përgjigje të thirrjes për t'u dëgjuar sot në komision, do ta shihni se mungon vullneti i Presidentit për të marrë pjesë në këtë komision hetimor, sepse nuk e njeh dhe e konsideron të gjithë këtë procedurë si fiktive dhe që po përdoret në keqbesim nga ana e maxhorancës përkarshi Presidentit. Pra, fajtori është përsëri Kuvendi, është përsëri komisioni hetimor, i cili po vepron në bazë të një vendimi të Kuvendit, i marrë në përputhje me Kushtetutën, me Rregulloren e Kuvendit dhe me ligjin "Për komisionet hetimore"; po zbaton detyrat e lëna nga vendimi i atij që quhet përfaqësuesi i vetëm i sovranit në Republikën e Shqipërisë, që është Kuvendi i Republikës së Shqipërisë; po zbaton me rigorozitet të gjitha procedurat që na detyron ligji për të bërë një proces të drejtë për një çështje që është e një rëndësie edhe më e madhe sesa çështjet e tjera, sepse flitet për verifikimin e shkaqeve të shkarkimit të Presidentit, të kërkuar nga 49 kolegët tanë deputetë, nga një Kuvend legjitim dhe nga një komision hetimor legjitim. Thënë këto, del qartë se në shkresë ne kemi vullnetin e qartë të Presidentit për të mos marrë pjesë dhe për të mos iu bindur detyrimit për komisionin hetimor: të thirret dhe të dëgjohej.

Sigurisht, Kodi i Procedurës Penale i parashikon mjetet për ta bërë të mundur prezencën me forcë, por, për sa kohë mungon vullneti, unë mendoj se nuk është e nevojshme të vijojmë me hapat e tjerë, sepse po sipas Kodit të Procedurës Penale, por edhe sipas rregullave të shqyrtimit të çështjeve në komision hetimor, çdolloj qëndrimi i personit, që ka detyrime në një procedurë hetimi nga komisioni hetimor, do të mbahet në konsideratë në vlerësimin e çështjeve dhe të fakteve të hetimit, si dhe në vlerësimin përfundimtar që do t'i bëhet çështjes.

Sigurisht, të gjitha këto akte, të gjitha këto qëndrime dhe të gjitha këto shkresa do të merren në konsideratë nga ne, do të jenë pjesë e verifikimit dhe e vlerësimit tonë përfundimtar.

Kjo është me pak fjalë përgjigjja e asaj që ju kërkuat. Por, nga ana tjetër, më duhet të rikujtoj këtu se në komisionin e mëparshëm, që ka qenë përsëri një kërkesë e kolegëve tanë deputetë për shkarkimin e Presidentit në lidhje me zgjedhjet e 30 qershorit 2019 dhe me emërimet në Gjykatën Kushtetuese, Presidenti ka marrë pjesë; ka qenë i njëjti Kuvend, me të njëjtën përbërje dhe ka qenë i njëjti raport, le të themi, maxhorancë-opozitë, siç ishte kur është bërë shqyrtimi i asaj kërkesë me shqyrtimin e kërkesës që po bëhet këtu. Pra, në atë kohë është njohur nga Presidenti, nuk ka pasur ndonjë kundërshtim, ndërkohë sot kemi një standard tjetër të Presidentit që nuk e njeh, sepse duket qartë në shkresën që ka sjellë.

E ripërsëris, ne veprojmë në bazë të vendimit të seancës plenare të Kuvendit për ngritjen e komisionit hetimor me një objekt të qartë të përcaktimit të punës sonë. Jemi legjitimë, se na duhet të përmendim këtu edhe disa fakte që ndoshta do t'i zgjerojmë, do t'i shtjellojmë më shumë në seancën kur të hapim debatin, por të gjitha pretendimet për mosnjohjen e legjitimitetit të një Kuvendi janë tashmë çështje të ezauruara edhe nga ai, që, në fakt, për vetë Presidentin është shumë i rëndësishëm dhe nuk i del dot kundër, gjithnjë e respekton dhe e vlerëson, është Komisioni i Venecies. Për sa kohë Komisioni i Venecies në opinionin për ndryshimet e Kushtetutës, për sistemin zgjedhor dhe ndryshimet e Kodit Zgjedhor për të njëjtën çështje, e ka thënë e zeza në të bardhë që parlamenti është legjitim dhe funksional dhe ia ka dalë, me gjitha problematikat e krijuara nga djegia e mandateve e të tjera (pra nga ato gjëra që janë konsideruar të pazakonta në demokraci), të ushtrojë të gjitha funksionet e veta dhe t'u përgjigjet detyrave që i ka caktuar Kushtetuta, si përfaqësues i sovranit, që është populli.

Kështu që në këtë fazë që jemi tani, unë çmoj që nuk ka vullnet nga ana e Presidentit për t'u dëgjuar në këtë komision dhe, për sa kohë që mungon vullneti dhe, për sa kohë që ky komision në mënyrë aktive e konkrete dhe në mënyrë objektive i ka realizuar të gjitha mundësitë për t'i

mundësuar Presidentit të jetë i pranishëm dhe të shprehë pikëpamjet e veta lidhur me procedurën që po kryhet në këtë komision hetimor, unë mendoj që, për sa kohë mungon vullneti nga ana e Presidentit, është jo e logjikshme që ne të vijojmë me këtë proces pambarimisht, sepse kemi një plan pune dhe kemi rregulla, që e normojnë aktivitetin e komisioneve hetimore, dhe të vendosim në përputhje me atë që kemi në objekt të punës. Për ne rëndësi ka hetimi dhe të garantohen të drejtat e palëve të përfshira në këtë proces hetimor, gjë që mua më rezulton se proceduralisht ne i kemi ezauruar dhe i kemi respektuar në mënyrën më të plotë të mundshme.

Faleminderit!

Alket Hyseni - Faleminderit, zonja Bushka!

Zoti Braho, fjala për ju.

Spartak Braho - Unë nuk dua t'i heq asnjë presje shpjegimeve profesionale të zonja Bushka, sepse ashtu është, Presidenti ka detyrimin të sillet edhe me forcë, të gjejë mjetet, por është çështje vullneti. Kjo do të thotë se ai nuk ka vullnet, që është më kryesorja, të njohë këtë Kuvend, të njohë komisionin hetimor dhe të paraqitet në bazë të kërkesave që bën parlamenti.

Megjithatë, unë do ta shtroj çështjen ndryshe. Ky President nuk ka karakter dhe kjo është themeloria. Mua më kujtohen ngjarjet e viteve të shkuara, ku ky President, në pozitën e Kryeministrit në atë kohë, e mori me dhunë mister debulesën, (Myslimit mund t'i kujtohet, sepse është deputet i vjetër), Berishën, ashtu siç Berisha e ka marrë këtë me dhunë në 1994, në ngjarjet e Poliçanit. Tani, unë vras mendjen, a ishin këta skenarë të kurdisur midis tyre?! Pse s'vjen ky sot në parlament, i thirrur nga komisioni hetimor?! Ky, përveç të tjerave, në materialet që na janë servirur dhe i kemi përpara, akuzohet për thirrje me dhunë dhe për dhunë, parashikuar nga neni 223 i Kodit Penal. A i mungon e drejta komisionit hetimor për ta thirrur?! Unë jam dakord me logjikën dhe shpjegimet që dha zonja Bushka, por ne duhet të shfaqim vullnetin tonë. Ai duhet thirrur me dhunë nesër. Kështu që, ta votojmë këtë propozim. Ky është mendimi im.

Alekt Hyseni- Faleminderit, zoti Braho!

Zonja Hysi, fjala për ju.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Dua ta falënderoj kolegën Bushka për përgjigjen shumë të detajuar dhe profesionale që dha në lidhje me pyetjen që bëri kolegu Murrizi. Nga ana tjetër, në lidhje me shkresën që na keni vënë në dispozicion të sjellë nga kabineti i institucionit të Presidentit të Republikës, dua të theksoj që ne jo pa qëllim ia kemi adresuar Presidentit të Republikës kërkesën për t'u paraqitur për të

dëshmuar, në mbështetje të nenit 16 për ligjin “Për ngritjen, organizmin dhe funksionimin e komisioneve hetimore parlamentare”. Së pari, e theksoj këtë pasi, të nderuar kolegë dhe kolege, në shkresën që ka mbërritur, që mban datën 21 maj 2021, aludohet që komisioni hetimor dhe ne, deputetët, nuk i kemi lexuar përgjigjet e mëparshme të Presidentit dhe kemi adresuar përsëri dy kërkesa të tjera. Pra, duke vënë në shkresë faktin që ne nuk i shqyrtojmë, nuk i lexojmë shkresat, sepse, po t’i lexonim, nuk do t’i adresonim. Në fakt, kjo është për transparencë, për rekorde dhe për të sqaruar publikun e gjerë. Çdo deputet i këtij komisioni dhe unë, personalisht, i kam lexuar përgjigjet e kabinetit të Presidentit të Republikës. Uroj, shpresoj dhe dua shumë që Presidenti, si përfaqësues i unitetit të popullit, të mos ishte autori i shkrimit të këtyre përgjigjeve, por të ishin lapsuse ose lajthitje të stafit të Presidentit të Republikës, pasi në të gjitha mbledhjet që janë transmetuar edhe *online*, ne kemi theksuar që, për shkak të ngarkesës që Presidenti i Republikës pretendon, të aktivitetit të shtuar politik në këtë periudhë, ta zgjedhë vetë ditën dhe orën, duke e lënë të hapur dhe, normalisht, në një komision hetimor parlamentar një fleksibilitet ose një liri kaq të madhe për të thirrur dëshmitarin nuk e kemi pasur, të paktën në përvojën e komisioneve hetimore parlamentare, ku unë kam qenë pjesë. Pra, ajo që shkruhet që ne, si komision, dhe deputetë anëtarë të këtij komisioni nuk i lexojmë letrat dhe e ripërsërisim kërkesën, nuk qëndron. Kjo është bërë për t’i dhënë çdo ditë mundësi në çdo orë të ditës, në fundjavë, madje edhe në festa, siç ka thënë dhe kryetrari i komisionit, që Presidenti i Republikës të dëgjohet, të dëshmojë, meqenëse thotë se ka qenë në pamundësi objektive për t’u paraqitur.

Në lidhje me pjesën e dytë, ku shprehet që nuk mund të bëhet fjalë për prezencën e tij përpara një strukture që është antikushtetuese, nuk do të doja ta komentoja sot, pasi ne do t’i administrojmë të gjitha dokumentet, aktet dhe do të diskutojmë në ditët në vijim. Por mendoj e vlerësoj se kjo sjellje, kjo gjuhë e shkresës, që mban brenda mungesën e respektit të parimeve kushtetuese dhe të rolit që duhet të luajë Presidenti i Republikës, bien totalisht ndesh me këto parime dhe nuk është aspak gjuhë etike dhe zyrtare.

Së fundi, në lidhje me propozimin e kolegut Braho për të thirrur dëshmitarin, pra Presidentin e Republikës me forcë, unë nuk do të doja që në këtë periudhë kaq të ngarkuar, me modelin më të shëmtuar të përcjelljes së mesazheve politike nga përfaqësuesi më i lartë i shtetit, ne të ofrojmë para publikut të gjerë shfaqje, të cilat nuk janë aspak në të mirë qoftë për qytetarët, për imazhin e republikës parlamentare, për imazhin e institucionit, pasi boll është dëmtuar imazhi i institucionit të Presidentit të Republikës.

Prandaj, bie dakord me propozimin që bëri zonja Bushka. Ne të procedojmë. Unë do të sugjeroja të mos i drejtonim më kërkesa institucionit të Presidentit të Republikës. Kemi ezauruar çdo mundësi, çdo mjet. I kemi lexuar të gjitha letrat dhe nuk do të doja që në arkivin e Kuvendit të Shqipërisë brezat e sotëm, ata që do të vijnë më pas, si dhe të gjithë ata që do të studiojnë veprimtarinë parlamentare, funksionimin e parlamentarizmit, funksionimin e demokracisë në Shqipëri, të gjejnë letra, të cilat do t'iu vinte turp t'i lexonin dhe të kujtojnë këtë periudhë që nuk është aspak në nderin e çdo shqiptari të ndershëm që lufton, punon për të mirën e këtij vendi dhe për të ngritur emrin, prestigjin e vendit tonë brenda dhe jashtë.

Unë, me gjithë respektin që kam për zotin Braho, do të thosha që nenin 60, paragrafin e tretë, të mos e zbatojmë.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Zoti Braho, ju lutem, pa debat!

Zoti Murrizi.

Myslim Murrizi – Po shikoj paragrafin e zotit Panariti, sepse ai e ka firmosur si shkresë. Me sa shikoj, është shpjegim juridik nga një jurist me përvojë, siç është zoti Panariti. “Ky është tregues i mosshqyrtimit të përmbajtjes së saj nga ana e deputetëve të Kuvendit”. Në 4 vjet në parlament kam lexuar jo pak shkresa të firmosura: nga tenderi i lopëve, 3 mijë e 200 euro një lopë, kur ka qenë ministër i Bujqësisë në vitet 2013- 2017, në dhjetor të vitit 2016 dhe në janar- shkurt të vitit 2017 dhe deri te sistemi i vadtjes me pika, 8 milionë euro në Divjakë që nuk ka as një tub të shtrirë. Siç duket, Presidenti i Republikës, ose ata që e këshillojnë, e njohin Kuvendin me vite. Në vitet çift e njohin, në vitet tek nuk e njohin.

Ndaj, zonja Hysi, nuk besoj se ka ndonjë gjë personale me përbërjen e komisionit, se përveç zotit Çaçani që ka qenë edhe në komisionin e parë hetimor, që është njohur nga Meta, ne të tjerët nuk kemi qenë. Por unë nuk mendoj se e ka me emrat e komisionit, por besoj se e ka me vitet. Po të ishte ky komision në vitin 2022, do të vinte Meta, sepse vitet çift i respekton.

Për sot unë pyeta për kureshtje, po e mirëkuptoj mosardhjen e tij. Besoj do të ketë shkuar në Përmet në simbol të festës së 24 Majit të vitit 1944, Kongresit të Parë të Komunistëve, të cilët gjatë fushatës, kam parë që Meta i ka dekoruar, i ka respektuar të gjitha festat, edhe partizanët e vjetër, edhe pse nuk ka më gjallë, por janë trashëgimtarët e tyre. Mendoj se do të jetë në këtë lloj eventit në Përmet. Kjo në sinkron edhe me hapjen e fushatës për të zgjedhur kryetarin, zoti Braho te PD-ja, se edhe ata sot e fillojnë, meqë më lidhen dy ngjarje.

E mbaj mend mirë 28 nëntorin e vitit 2000, kur është shoqëruar me forcë, se kam qenë deputetë në periudhën '97-2001, por, siç duket, mes shqiptarëve ekziston sindromi i Stokholmit, kush të rreh, të do më shumë, ose do të duash më shumë atë që të rreh.

Edhe unë jam dakord me zonjën Hysi që nuk kemi pse të dërgojmë shkresa, besoj që komisioni të jetë brenda afateve të përcaktuara nga Kuvendi i RSH-së. Unë e kam thënë edhe herë tjetër në mbledhje, respektet për institucionet e këtij vendi duhet t'i kemi të barabarta, të gjithë shtetarët e këtij vendi, deputetët për institucionin e Presidentit, Presidenti për institucionin e Kuvendit. Respektet personale pastaj, nëse nuk më respekton një herë personalisht, as ma ndjen fare dhe nuk më vërshtellen se çfarë pune bën dhe çfarë karrige të shtetit ke. Unë nuk besoj që e kemi thirrur personalisht Presidentin në këtë komision. Nuk mendoj që të ketë mes nesh, kolegë deputetë, që të kenë pasur nevojë në vitet e ushtrimit të detyrës së tij si President për ndonjë dekoratë, për ndonjë firmë, për ndonjë emërim në gjykatë, unë, të paktën, jo, as kalamajtë e mi, as familja ime. Pra, nuk janë pjesë e institucioneve që firmosen, dekretohen apo dekorohen nga Presidenti i Republikës. E njoh edhe unë që nga viti '91, e njoh në ato vitet '93-'94, se 3 muaj ka ndenjur në Divjakë, por problemi është se komisioni hetimor i këtij kuvendi që nga Meta është njohur me dekret, sepse ka dekretuar 5 qershorin e votuar nga ky Kuvend me votë të cilësuar. 84 vota të këtij Kuvendi, që Meta sot nuk e njih, është dekretuar nga Meta me drita ndezur, me llambë të kuqe për 24 orë.

Pra, ky President dekretoi një shumicë të cilësuar, megjithëse prej 2 vjetësh thoshte se janë vetëm 82 deputetë të këtij Kuvendi. E dekretoi, sepse brenda ishte edhe firma e Petrit Vasilit, kështu që nuk më impresionon fare nëse e njih një vit po e një vit jo, e njih komisionin në vitin 2020, nuk e njih në komisionin në vitin 2021.

Të administrojmë të gjitha shkresat e ardhura nga institucionet! Nuk di çfarë është bërë, meqenëse nuk kam qenë dy mbledhjet e fundit. Nuk di a kanë ardhur përgjigje nga institucionet që unë kërkova, por edhe kolegë të tjerë kërkuan, Drejtoria e Policisë së Shtetit apo SHIK. Të administrojmë përgjigjet, të bëjmë debatin e zakonshëm, të votojmë raportin përfundimtar dhe le të shkojmë në seancë, seanca të vendosë dhe pas seancës (nëse seanca vendos në favor të votimit pro shkeljeve të Presidentit Meta, do të jetë Gjykata Kushtetuese që do të thotë fjalën e fundit).

E kam thënë edhe një herë tjetër, se nga kjo anë jemi të qetë, sepse kemi edhe një organ mbi vete që do të gjykojë ligjshmërinë e vendimit tonë.

Faleminderit!

Alket Hyseni - Faleminderit!

Që mos të zgjatemi në këtë aspekt, ky komision është treguar i kujdesshëm që të zbatojë me përpikëri gjithë procedurën e parashikuar në Kushtetutë, në Rregulloren e Kuvendit dhe ligjin e komisionit hetimor, prandaj ka qenë kjo kërkesë, e cila është bazuar në dy momente të ndryshme juridike.

Momenti i parë është e drejta që ka personi nën hetim, në rastin konkret Presidenti i Republikës, për të dhënë qëndrimin e tij, të drejtë të cilën e ka në dy momente në Komisionin e Ligjeve dhe në seancën plenare, si dhe detyrimin që ka ai dhe ky komision për ta thirrur dhe dëgjuar gjatë hetimit.

Për ne është e rëndësishme thellësia e hetimit. Në hetimin e kemi pasur të plotë, ne kemi administruar shkresa, ne kemi administruar prova filmike, qëndrime zyrtare, fakte të njohura botërisht, kështu që për ne nuk përbën ndonjë risi ardhja ose mosardhja. Ndoshta ajo do të ishte më e vlefshme, së pari për të zbatuar detyrimin kushtetues dhe betimin, në raport me ligjin. Së dyti, për të zbatuar Rregulloren e Kuvendit, që një është ligj po i rëndësishëm, për të zbatuar ligjin e komisioneve hetimore, për të zbatuar parimin e transparencës para publikut.

Unë do të dëshiroja me gjithë zemër, që të mos ishim fare në këtë komision. Nuk është ndonjë kënaqësi e madhe për dikë, që të ngrejë komisione kundër Presidentit të Republikës së vendit të tij. Unë do të dëshiroja që Presidenti i Republikës sime të mos kishte lënë shkak fare për këtë situatë.

Do të dëshiroja që Presidenti i Republikës sime të ishte shembull i zbatimit të ligjit, i zbatimit të procedurës, shembull i qytetarisë, dhe të ishte sot këtu qoftë dhe vetëm për kaq.

Megjithatë, nuk do të merremi më gjatë. E bëmë thirrjen për të qenë strikt me procedurën, jo se kjo do të prodhonte ndonjë risi. Jemi të kompletuar nga pikëpamja hetimore, kështu që unë do të hedh për votim propozimin e parë, që është propozimi për të mbyllur çështjen e administrimit e për këtë pikën e dytë, dhe të mos vazhdojmë më me procedurën për thirrjen e Presidentit.

Kush është dakord me këtë propozim? Me ngritje dore, ju lutem!

Dakord të gjithë.

Edhe Zoti Braho. Mund të bësh edhe një koment.

Hodhën më votë propozimin më të largët, që është mbyllja e hetimit. Sipas Rregullores, propozimi më i largët hidhet për votim i pari. Ndërkohë, propozimi për vijimin e një procedure quhet propozim më i afërt.

Kësisoj, ju falënderoj për këtë pikë.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: Administrimi i provave.

Unë do t'jua lexoj të gjitha provat një e nga një, dhe do të shpreheni...

Ju lutem, ju lutem, se interferon.

Do t'i lexoj në grup, dhe ne do të shprehemi në lidhje me administrimin e tyre. Para se të them këtë, ju bëj me dije se në adresën e Komisionit Hetimor kanë ardhur edhe shkresa nga qytetarë apo grupe qytetarësh, në lidhje me të cilat, i lutem sekretarisë që t'ia bëjë me dije komisionit. Për shembull, janë një grup pensionistësh, por është gjithashtu edhe zoti Frrok Çupi, që i ka nisur një kërkesë Komisionit Hetimor. Pasi shprehin vlerësimin për këtë komision, përcjellin kërkesat apo vërejtjet e tyre, apo dëshirojnë të bëhen pjesë e dëgjesave, që të dëshmojnë për shkelje nga ana e zyrës apo institucionit të Presidentit të Republikës në raport me ta.

Duke i mirëkuptuar qytetarët, i sqarojmë se ky nuk është objekt i punës së komisionit, por megjithatë, këto dokumente do t'u bëhen me dije deputetëve, të cilët do të mund t'i kenë në dispozicion në lidhje me gjykimin e tyre moral dhe politik, por jo në kuptim të provave procedurale.

Atëherë, le të vazhdojmë me provat.

1. Kërkesa e 49 deputetëve për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

Unë po i kursej numrat e protokollit dhe datat, sepse lodheni edhe ju, edhe publiku. Secili i ka përpara dokumentet

2. Njoftimi i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut drejtuar Presidentit të Republikës, në lidhje me pjesëmarrjen në seancë dëgjimore në atë komision.

3. Shkresa e Presidentit të Republikës drejtuar Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

4. Raporti i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Presidentit të Republikës, zoti Ilir Meta.

5. Regjistrimet e programeve të transmetuara nga subjektet audiovizive në format elektronik, CD, gjithsej janë 27, të dërguara nga Autoriteti i Medieve Audiovizive me shkresën e tyre përkatëse dhe të protokolluara në Kuvend. Pra, janë 27 lidhje për secilin nga disqet që përmbajnë pamjet.

6. Regjistrimet e programeve të transmetuara nga subjekte audiovizive në format elektronik, gjithsej 10, të dërguara me një shkresë vijuese nga Autoriteti i Medieve Audiovizive.

7. Informacioni i dërguar nga Gjykata Kushtetuese mbi korrespondencën me Presidentin e Republikës gjatë periudhës objekt hetimit.

8. Informacion nga Prokuroria e Përgjithshme në lidhje me veprat penale apo kallëzimet e regjistruara lidhur me zgjedhjet për periudhën e fushatës zgjedhore 2021.

9. Informacion nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar lidhur me veprat penale apo kallëzimet e regjistruara në periudhën objekt hetimi.

10. Informacion i dërguar nga Shërbimi Informativ i Shtetit lidhur me objektin e hetimit të komisionit.

11. Informacioni i klasifikuar sekret në nivelin e klasifikimit “i kufizuar” dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit lidhur me objektin e hetimit.

12. Informacion i dërguar nga Bashkia Tiranë lidhur me procedurat e kryera prej saj gjatë ekzekutimit të lirimit të ambienteve të zyrave të Partisë Fryma e Re Demokratike, aktet përkatëse si dhe informacioni me ndërhyrjet dhe veprimet e kryera nga Presidenti i Republikës lidhur me këtë çështje.

13. Informacion i dërguar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve lidhur me objektin e hetimit dhe mbi korrespondencën me dhe për Presidentin e Republikës.

14. Informacion nga Shërbimi Legjislativ në Kuvendin e Shqipërisë lidhur me dekretet e Presidentit të Republikës për kthim të ligjeve për rishqyrtim, përcjellë komisionit.

15. Informacion nga Shërbimi i Kërkimit Parlamentar në Kuvend mbi shkarkimin e Presidentit të Republikës në Lituani.

16. Informacion nga Shërbimi i Kërkimit Parlamentar në Kuvend në lidhje me bazën ligjore dhe procedurat e shkarkimit të kryetarit të shtetit në disa vende europiane.

17. Njoftimi i Presidentit të Republikës në lidhje me ngritjen e komisionit hetimor, objektin e hetimit, si dhe të drejtën për t’u shprehur në komision.

18. Kërkesë për informacion drejtuar institucionit të Presidentit të Republikës lidhur me titujt, dekoratat e akorduara nga Presidenti, personave që u është akorduar, si dhe procedurat e akordimit dhe dhënies së tyre, aktivitetet protokollare, vizitat, si dhe takimet e organizuara nga zyra e Presidentit me individë, institucione apo subjekte të ndryshme, në të cilat ka qenë pjesëmarrës Presidenti për periudhën objekt hetimi.

19. Thirrje për seancë dëgjimore drejtuar Presidentit të Republikës.

20. Letra e Presidentit të Republikës drejtuar Kryetarit të Kuvendit.

21. Kërkesë për informacion drejtuar institucionit të Presidentit të Republikës lidhur me dekretet e dhënies së shëndetësisë nga Presidenti i Republikës, personave që u është dhënë shtetësia, si dhe procedura e ndjekur për dhënien e tyre. Korrespondenca e Presidentit të Republikës me institucionet ligjzbatuese lidhur me çështje dhe problematika të procesit zgjedhor, si dhe me rendin e sigurinë publike për periudhën objekt hetimi.

22. Rithirrje për seancë dëgjimore drejtuar Presidentit të Republikës.

23. Rithirrje për seancë dëgjimore përsëri drejtuar Presidentit të Republikës, shkresë e datës 21.

24. Shkresë e kabinetit të Presidentit të Republikës e datës 21.

25. Shkresë e kabinetit të Presidentit të Republikës e datës 24.

26. Raporti i ekspertit ligjor Artan Spahiu.

27. Raporti i ekspertit ligjor Erind Mërkuri. Këto janë aktet e administruara zyrtarisht nga ky komision në përmbushje të objektit të tij dhe në funksion të kryerjes së hetimit.

A ka dikush ndonjë rekomandim, nëse është ndonjë akt i protokolluar që mund të...?

Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Ju dëgjova zoti Hyseni. Materialet e AMA-s janë?

Alket Hyseni – Janë dy grupe të materialeve të ardhura me dy shkresa të ndryshme, janë 27 CD dhe 10 CD të tjera dhe të dyja janë administruar, i citova për administrim.

Spartak Braho – Nuk janë të transkriptuara?

Alket Hyseni - Janë të transkriptuara të gjitha. Ju jeni njohur me të dy grupet, janë ato që janë përcjellë që në mbledhjet e kaluara dhe janë ezauruar të gjitha kërkesat që ne i kemi bërë AMA-s. Kuptohet që AMA është përgjigjur vetëm për atë që ka objekt të punës së saj, ndërkohë që ne i kemi administruar më vete dhe ndoshta këtu mund ta citojmë më vete, administrimin e qëndrimeve nga rrjetet sociale. Ne i kemi shfaqur, prandaj do të kërkoja që një pikë e veçantë të jetë administrimi i qëndrimeve të mbajtura në rrjetet sociale nga Presidenti i Republikës apo subjekte të tjera, të cilat janë shqyrtuar nga ky komision.

A keni ndonjë merak tjetër?

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Jam dakord me aktet që lexuat, por te pika 3, tek aktet e administruara në procesin hetimor, ku flitet për njoftimet sa i takon dëgjësës së Presidentit në Komision për Çështjet Ligjore, do të doja që të ishte e plotë e gjithë praktika, sepse është shkruar vetëm shkresa përgjigje dhe nuk flitet për shkresën e dytë, për dëgjësën në datën 6 maj.

Sekretaria të mbaj të gjithë dosjen e plotë të komisionit të Çështjeve Ligjore kur është diskutuar shqyrtimi paraprak i kërkesës, për t'ia kaluar më tej seancës plenare dhe e gjithë praktika të jetë pjesë e administrimit. Pra, jo vetëm shkresat, por e gjithë praktika që shoqëron raportin e Komisionit të Çështjeve Ligjore në lidhje me këtë çështje. E para.

E dyta, sa u takon transkriptimeve. Një pjesë e materialeve të ardhura nga AMA, në fakt janë të transkriptuara nga shërbimet e Kuvendit, prandaj të shtohet pika që edhe transkriptimet e atyre materialeve të jenë pjesë e administrimit.

Sa i takon sqarimit që dhatë më parë, zoti Hyseni, në lidhje me shkresat e ardhura nga subjekte të ndryshme, qytetarë apo shtetas të tjerë të Republikës së Shqipërisë që mund kenë të shprehur interes për t'u dëgjuar këtë proces nuk mund t'i administrojmë dot në cilësinë e provave si këto që kemi paraqitur, por ato mund të merren në shqyrtim nga të gjithë anëtarët e komisionit, të cilët mund t'u referohen për të krijuar edhe ata bindjen e tyre të brendshme, por nuk mund të jenë prova që të listohen këtu.

Megjithatë, do të doja të shtonim dhe një shkresë të fundit që mua më erdhi tani, por nuk e di nëse u është vënë në dijeni. Është po një përgjigje nga institucioni i Presidentit të Republikës, i datës 24.5.2021, e sotmja, me numër protokolli 1714...

E cituat?

Në rregull.

Atëherë, e kam marrë unë me vonesë.

Në bazë të Kodit të Procedurës Penale këto janë fakte botërisht të njohura dhe nuk ka nevojë që të administrohen si prova, por për efekt të qartësisë dhe për të qenë ne të saktë të gjitha komunikimet, shprehjet e mesazheve nëpër rrjetet sociale apo qëndrime të ndryshme publike, të cilat nuk janë te materialet e AMA-s, por janë nëpërmjet faqeve dhe rrjeteve sociale janë pjesë e administrimit. Konkretisht do të doja që, përveç materialeve që listuam, sa u takon statuseve në rrjetet sociale dhe që u lexuan në seancat e mëparshme, kur u prezantuan disa prova, por që janë edhe të listuara nga sekretaria, të shtohen edhe qëndrimet në rrjetet sociale për çështjet që lidhen me zgjedhjet ose proceset që janë duke u kryer aktualisht në Shqipëri, për të cilat ka një qëndrim

nga ana e Presidentit, sepse është shumë e rëndësishme për të gjithë kolegët që kur të vlerësojnë provat dhe natyrën e provave, dhe nëse jemi para shkeljeve dhe shkeljeve të rënda, edhe qëndrimi i vetë Presidentit. Kjo ka rëndësi në këtë proces hetimi. Prandaj, duhet të kemi një panoramë të plotë të të gjithë aktivitetit. Kjo është kërkesa përfundimtare që kisha.

Alket Hyseni – Bie dakord për këtë element, pra për atë të parin. Sa i takon shkresës për njoftim për t'u dëgjuar nga Komisioni i Ligjeve, është cituar, si e gjithë praktika, raporti i Komisionit të Ligjeve, bashkë me shqyrtimin e një grupi deputetësh, për nisjen e procedurës së shkarkimit nga Presidenti i Republikës, aty të specifikohen njoftimet për Presidentin për këtë procedurë, por edhe shkresat që ka njoftuar. Pra, e gjithë praktika, e rëndësishme është të mos mungojë asgjë.

Ndërkohë, unë sjell në vëmendje që ne kemi rënë dakord që duhet të administrojmë raportet e organizmave të ndryshëm, një pikë e veçantë kjo lidhur me fushatën, me ditën e heshtjes, me ditën e zgjedhjeve ose me qëndrime, qoftë edhe më pas, që kanë një lidhje organike dhe mund të na ndihmojnë ne në debatin e nesërm, por edhe qëndrimin e gjithsecilit nga anëtarët e këtij komisioni, dhe përtej kësaj, edhe ndoshta të gjithë seancën plenare për të çmuar lidhur me këtë objekt hetimi dhe me ecurinë e kësaj procedure.

Raporti i OSBE-ODIHR-it është shumë i rëndësishëm, sepse është organizmi më i specializuar në botë për çështjet e zgjedhjeve. Ky raport, qoftë paraprak, qoftë deklarimet e tyre në konferenca të ndryshme, qëndrime zyrtare të drejtuesve ose anëtarëve të këtyre organizmave duhet të jenë. Prandaj e kemi diskutuar në planin e hetimit, ju lutem, sekretaria të shtojë një pikë që të administrohen edhe këto.

Nëse nuk keni ndonjë çështje tjetër, atëherë të shprehemi me votë për administrimin e të gjitha provave sa unë citova, duke shtuar edhe propozimet mia, edhe të zonjës Bushka.

Po zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Në kuadër të propozimit tuaj të fundit për të marrë raportet e institucioneve që kanë monitoruar zgjedhjet, ku ka pasur konstatime ose qëndrime edhe në lidhje me gjuhën, komunikimin e të gjitha partive dhe funksionarëve, do të sugjeroja që, përveç raportit paraprak të OSBE-ODIHR-it, deklaratave që ka bërë drejtuesi i misionit, ne duhet të kemi edhe raportet e vëzhguesve vendorë. Edhe ato kanë raporte paraprake. Prandaj do t'ju lutesha që shërbimi i sekretarisë së komisionit tonë t'i sigurojë edhe këto raporte, të cilat janë publike, njihen dhe janë të certifikuara.

Alket Hyseni – Jeni njohur elektronikisht me to, por që të administrohen në cilësinë e provës.

E kuptova!

Vasilika Hysi – Ne jemi njohur, por, edhe për barazi, edhe për të vlerësuar rolin që luajnë institucionet vendore që vëzhgojnë zgjedhjet, si shoqëria civile, që kanë një përvojë shumë të gjatë, dhe janë të certifikuar, pra kanë marrë nga KQZ-ja autorizimin për të qenë vëzhgues, qoftë afatgjatë ose afatshkurtër, edhe ato të administrohen.

Faleminderit!

Alket Hyseni - Atëherë, e hedhim në votë administrimin e listës bashkëngjitur me propozimet e zonjës Hysi, zonjës Bushka dhe propozimet e mia. Kush është dakord për administrimin e këtij volumi të provave? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

I lutem sekretarisë teknike të ribëjë listën e plotë dhe administrimit me detaje, jo me kuptim të përgjithshëm, por duke e listuar. Pra, kur të vijmë te çështja e raporteve ndërkombëtare, do të jetë nominale, për shembull: raport i OSBE-ODIHR-it i datës kaq; qëndrim paraprak në konferencën për shtyp i datës kaq e aq i këtij institucioni; raport i kësaj organizate të akredituar apo të autorizuar nga KQZ-ja. Pra, duhet të jenë të detajuara dhe të qarta për efekt procedural, por edhe për lehtësi të punës së anëtarëve të komisionit në çdo formë, në rrugë elektronike, por edhe të administruara në *hard-copy* për shkak të procedurës.

Të gjitha vërejtjet që u bënë këtu do të pasqyrohen. Pra, propozimi duhet marrë në detaje për t'u administruar çdo element.

Me këtë mbyllim hetimin si komision hetimor, që do të thotë që secili nga anëtarët ka një volum të madh provash, dokumentesh, qëndrimesh, deklaratash për të vlerësuar, ju keni pasur kohë gjatë gjithë këtyre ditëve prej dy javësh, do të keni kohë deri nesër, pasi është dita e debatit për provat, ku secili ka të drejtë të shprehë vlerësimin për secilën provë dhe qëndrimin e tij për çështjet, sepse proceduralisht do të kemi një mbledhje ditën e nesërme, hapa, të cilët na i kushtëzon në mënyrë strikte ligji për komisionin hetimor dhe Rregullorja e Kuvendit, pastaj do të kemi një mbledhje për raportin paraprak që, në bazë të diskutimit, nëse do të mbyllet nesër, do të caktojme ditën për raportin paraprak, dhe brenda afatit të vendosur nga seanca plenare e Kuvendit, ne duhet të dorëzojmë raportin përfundimtar, që i bie besoj brenda kësaj jave ta përmbyllim atë.

Jeni dakord me këto hapa proceduralë?

Te pika “çështje të tjera” nuk besoj se ka ndonjë gjë tjetër për diskutim.

Këtë mbledhje e konsiderojmë të mbyllur.

Njoftimin për mbledhjen e ditës së nesërme, orarin dhe rendin e ditës do t’jua njoftojmë elektronikisht dhe me forma të tjera komunikimi.

Ju falënderoj të gjithëve për diskutimet e sotme, për seriozitetin tuaj dhe mirë u takofshim nesër!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

Kryetar
Alket Hyseni

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Evi Naku